



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.10.2022, ora 14:00

Drejton mbledhjen Sokol Binaj – Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

Rendi i Ditës:

Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022

Marrin pjesë:

1. Sokol Binaj	(Kryetar)
2. Marsida Xhaferllari	(zëvendës kryetare)
3. Elsa Toska	(anëtare)
4. Anila Leka	(anëtare)
5. Edlira Petri	(anëtare)
6. Klodiana Mema (Veizi)	(anëtare)
7. Etien Kapo	(anëtar)
8. Enton Dhimitri	(anëtar)
9. Genti Xholi	(anëtar)
10. Sandër Simoni	(anëtar zëvendësues)

Marrin pjesë si vëzhgues të përhershëm:

1. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, Enio Haxhimihali

HAPET MBLEDHJA: ora 14:19

Kryetari Sokol Binaj – Atëherë e deklarojmë të hapur mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësin, në funksion të vazhdimësisë të punës të këtij Këshilli, lidhur me vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve, për gjyqtar në Gjykatë Kushtetuese, vakancë e Presidentit të Republikës; Ibrahim, Vorpsi si dhe Marku. Përpara se mbledhja të konstituohet, të futet në dhomën e këshillimit, paraprakisht verifikohet prezencën e pjesëmarrësve, pjesëmarrja e anëtarëve.

Të pranishëm janë: Zonja Xhafellari, zonja Toska, zonja Leka, zonja Petri, zonja Mema (Veizi), zoti Kapo, zoti Dhimitri, zoti Xholi, dhe Binaj. Është i pranishëm dhe anëtar i zëvendësues zoti Simoni

I pranishëm në mbledhje është përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, Enio Haxhimihali.

Atëherë, përpara se të procedojmë me fillimin e procedurës në dhomë këshilli të pikëzimit, pastaj të renditjes së kandidatëve, administrohen aktet e ekspertimit të gjuhës së huaj të vëna në dispozicion të këtij Këshilli nga ekspertët e fushës dhe kjo ishte arsyeja përse mbledhja e djeshme u shty për ditën e sotme. Aktet e ekspertimit lidhur me vlerësimin e nivelit të gjuhëve të huaja për të tre kandidatët. Mendimet e ekspertëve të thirrur nga ana e kësaj mbledhje.

Mendim, lidhur me nivelin e vlerësimit të gjuhës së huaj për kandidaten znj. Arta Vorpsi, protokolluar me nr. 625, datë 27.10.2022, nga eksperti Prof. Dok. Ema Kristo.

Akti i ekspertimit, mendimi i vlerësimi të gjuhës së huaj, të ekspertes dok. Etleva Kondi i depozituar në sekretarin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 628, datë 27.10.2022, për vlerësimin e nivelit të gjuhës së huaj për kandidati z. Genti Ibrahim. Akti ekspertimi, mendimi i vlerësimit të ekspertes Dok. Etleva Kondi, për vlerësimin e nivelit të gjuhës së huaj për kandidaten znj. Arta Marku, i depozituar në sekretarin e KED-së me nr. 629 prot, datë 27.10.2022. Aktet e ekspertimit janë në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve në mbledhje ku ekspertët kanë bërë vlerësimet respektive lidhur me nivelin e njohjes së gjuhës së huaj nga të tre kandidatët. Respektivisht për gjuhën angleze për kandidatin Ibrahim, vlerësimi 3 pikë. Për gjuhën Gjermane për kandidatën Vorpsi, vlerësimi 3 pikë dhe për gjuhën angleze për kandidaten Marku, vlerësimi 3 pikë. Të treja aktet e ekspertimit do ti bashkëlidhen dokumentacionit respektiv të të tre kandidatëve. Konsiderohet vënie në dijeni Këshilli lidhur me një sinjalizim të bërë nga kandidati Ibrahim drejtuar Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, më këtë përmbajtje...lexohet...ka paraqitur opservimet e tij. Kandidatin e dëgjuam, e patëm të pranishëm, i dhamë të gjithë mundësit e duhura, thjesht për efekt të informimit në qoftë se ka një opinion, mund të ma thoni por për mua mun të ecim pa asnjë lloj problemi.

– Jo. Atëherë, vazhdojmë, tërhiqemi direkt në dhomë këshillimi.

Elsa Toska – më fal Kryetar, për efekt procesverbali mos ndoshta email-in e zonjës Marku ta paraqesni në Këshill, mirë do të ishte? Thjesht ta verbalizojmë në procesverbal por për korrektesë meqënëse e bërëm për një kandidatë. Thjesht për një barazi armësh midis kandidatësh.

Anëtarët – e kemi marrë. E ka sjellë ditën e mbledhjes.

Anëtarët flasin pa mikrofon

Sokol Binaj – atëherë, përveç sinjalizimit të zotit Ibrahim, kemi dhe një kërkesë të zonjës Marku, pranë këtij Këshilli në datën 26 Tetor, ora 11.22, më këtë përmbajtje...lexohet...kjo është kërkesa e bërë nga ana e kandidatës marku. Nëse keni ndonjë opinion lidhur me plotshmërinë e relacionit të saj nëse do të jetë e domosdoshme të kërkohet edhe ky informacion? Nëse, do të doni opinionin tim, unë jam për mos ta kërkuar. Nëse, ajo ka diçka për ta vënë në dispozicion, le ta sjelli, nuk ka asnjë pengesë deri ditën e fundit ajo ka qënë e hapur! Ndërkohë, unë nuk kam tagër, as arsye tu drejtohem institucioneve të ndryshme, nëse kanë ndërmend le të shkojnë. Nëse, keni ndonjë opinion tjetër alternativë, ma thoni! Në të kundërt, vazhdojmë.

Anëtarët – Vazhdojmë

Sokol Binaj- jemi dakort. – Dakort. Që është i plotë dokumentacioni, nëse zonja Marku kishte diçka për ta sjellë, mund ta sillnte në çdo moment. Atëherë, faleminderit!
Tërhiqemi në dhomë këshillimi, për të proceduar, me pikëzimin, renditjen dhe klasifikimin e tre kandidatëve, e vakancës së Presidentit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, tërhiqet në Dhomë Këshillimi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi u konsultua në dhomën e këshillimit, lidhur me pikëzimin për renditjen e përfundimtare të kandidatëve, përfundimisht, në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 5 të nenit 229, të pikës 2 të nenit 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikave 68, 70 dhe 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, pasi dëgjoji relatimin e relatorit, znj. Elsa Toska dhe si e bisedoi çështjen në tërësi,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022, si më poshtë:
 1. **Genti Ibrahim** - **88.38 pikë**
 2. **Arta Vorpsi** - **88.22 pikë**
 3. **Arta Marku** - **82.66 pikë**
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Tiranë më datë 28.10.2022

KRYETAR

Sokol BINAJ